

INTERVISTË ME MINIR DUSHIN

Prishtinë | Data: 29 tetor, 2018 dhe 24 nëntor, 2022
Kohëzgjatja: 137 minuta

Të pranishëm:

1. Minir Dushi (I intervistuari)
2. Erëmirë Krasniqi (Intervistuesja)
3. Anita Susuri (Intervistuesja)
4. Kaltrina Krasniqi (Intervistuesja/ Kamera)
5. Renea Begolli (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

[Intervistuesja kërkon nga folësi që ai të tregojë për familjen dhe për kujtimet e tij më të hershme. Kjo pjesë është prerë nga video-intervista. Pjesë e parë e intervistës është realizuar më 29 tetor, 2018]

Minir Dushi: Une rrjedhi nga një familje, familje e vjetër autoktone gjakovare e njohur nën mbiemrin Beg Dushi, Beg Dushi. Familja e, familja ime ka qenë e gjerë, baba im ka pasë pesë vllazën dhe të gjithë kemi jetu në një shtëpi bashkarisht kolektiv, përbashkët. Kemi pasë harmoni edhe dashuri shumë të madhe ndër veti. Baba im ishte kryefamiljari që qarkullonte të gjitha gjërat nëpërmjet tina. Kurse gjyshja ime e njoftun shumë Azize Hanmi, Azize Hanmi, ajo merrej me punë të shtëpisë, e kishte reja, i kishte katër reja për orgaznimin e punës në shtëpi. Nale [i drejtohet kamerës], p'e nali diçka, çka me thonë.

Kaltrina Krasniqi: Vazhdo, vazhdo.

Minir Dushi: S'ka gajle a? Jo unë p'e vazhdoj, po s'di çka thom...

Erëmirë Krasniqi: Për çka ish e njoftun nana jote?

Minir Dushi: Nana e, nana... familja ime merrej me qepjen e zhgunave, zhgunave. Punonin tirqi, herka, japonxha, jeleka. I kishim për traditë këto, po. E nana ime ka qenë shtëpiake, nuk ka pasë ndonji shkollë të veçantë. Kurse baba ka pasë shkollën Ruzhdi¹ të Turqisë atëhere, ka shkrujtë turqisht edhe shqip. E kom edhe në libër atje një letër të tina.

Erëmirë Krasniqi: Ku e keni kry shkollën fillore ju?

Minir Dushi: Shkollën fillore, një pjesë e kom kry në Gjakovë, në vendlindje, nja dy apo tri klasë në gjuhën, gjuhën serbe, pastaj shkollat u, u formunë në gjuhën shqipe kom vazhdu mësimet në klasën e

¹ Turk.: *Rüştiye*, do të thotë shkollë e mesme, ndryshe maturë, maturim.

katërt edhe të pestë, ashtu më duket. Pastaj kom vazhdu mësimet në gjimnazin e ulët të Gjakovës ku e kom kry, e kom kry... semimaturë quhej atëhere, gjysëm-matura.

Erëmirë Krasniqi: A ka qenë katër-vjeçare, a tetë?

Minir Dushi: Jo, katër-vjeçare, semimatura, gjysa do të thotë, po. Ishte viti 1946, pastaj kom fitu të drejtën me vazhdu në shkollë pak ma të lartë, po të mesmen, të mesmen...

Erëmirë Krasniqi: Shkollën e Lartë Pedagogjike a naj çka...

Minir Dushi: Mandej kom shku jom regjistru në Shkollën Teknike në Nish. Asokohe, në Kosovë nuk ka pasë shkolla teknike, ç'është e vërtetë po atë vit është themelu shkolla teknike, drejtimi i maqinerisë në, në Mitrovicë. Por unë e kom pasë drejtimin elektro, elektro. Kur kom shku në Nish asnjë fjalë serbisht nuk e kom ditë, atje kom mësu. Edhe ka qenë shkollë shumë serioze, kom fitu një njohuri shumë të madhe edhe gjuhën pas një viti asi e përvetësova. Kështu që, studimet në Universitetin e Beogradit në Fakultetin e Xehtarisë i kom kry me kohë dhe pa kurrfarë probleme.

Erëmirë Krasniqi: Zoti Minir, a të kthehem pak te koha kur keni qenë në fillore me na kallxu çfarë...

Minir Dushi: Kur?

Erëmirë Krasniqi: Sistemi edukativ si ka qenë, pse u bo shkolla në gjuhën shqipe mandej? Ju thatë që fillimisht ka qenë serbisht, mandej e kanë bo në gjuhën shqipe.

Minir Dushi: Në gjuhën shqipe...

Erëmirë Krasniqi: Qysh erdh deri te ajo?

Minir Dushi: Ah?

Erëmirë Krasniqi: Qysh erdh deri te ajo që kishit tash arsimim në gjuhën shqipe?

Minir Dushi: Po, pastaj pas shkrimit fillunë, filloi zhvillimi i arsimit në Kosovë. Atëherë, kështu që, përveç shkollave të mesme, do të thotë shkollave të mesme profesionale që ishte Shkolla Normale në Gjakovë u themelua. Por une, siç thashë vazhdova në Nish atje. Edhe gradualisht fillunë këtu themelimi i shkollave të ndryshme, drejtimeve të ndryshme në Kosovë. Por unë atëhere i kisha kry të gjitha por pas ardhjes sime, pas ardhjes sime si inzhinier, në vitin 1958 kom ardhë inzhinier i minierave në kombinatin e Trepçës, atëhere nuk ka qenë kombinati, por ka qenë Trepça, Nërmarrja Trepça, prej asaj...

Erëmirë Krasniqi: Zoti Minir...

Minir Dushi: Prej atij viti, '58, vazhdimisht kom punu në kombinatin, Kombinatin e Trepçës. '61-shin është themelu Shkolla e Lartë Teknike në Mitrovicë. Atëhere Këshilli Ekzekutiv i Kosovës që ishte kompetent më ka caktu drejtor i Shkollës të Lartë në Mitrovicë. Aty kom punu pesë vjet, pesë vjet...

Erëmirë Krasniqi: Zoti Minir, a po kthehem te ai tregimi ju jë jetësor që ka të bëj më Luftën Nacional-Çlirimtare edhe...

Minir Dushi: Po, po tash kthehem edhe anena. Po kështu ta përfundoj qita... kështu që pas pesë vjete, unë si inzhinier kom, më kanë caktu në Kombinatin e Trepçës, themelimin e Institutit për Plumb dhe Zink në Zveçan, ajo osht' themelu në 1965. Une kom qenë si drejtor i Institutit dymbëdhjetë vjet në Kombinatin e Trepçës. Njiheri kom punu në Universitet.

Me rastin e themelimit të Universitetit të Prishtinës une jam zgjedhë prorektor i parë i këtij institucioni të lartë shkollor. Dhe aty kom punu dy vjet si prorektor dhe pastaj në Universitet, në Universitet... unë mendoj që i vetmi kuadër në Kosovë që kom punu paralel si në prodhim Trepçën, ashtu edhe në Kombina... ashtu edhe në Universitet. Vende të punës i kom pasë dy, ashtu edhe kam qenë i dhanun pas shkencës, por njihere edhe pas prodhimit. E kështu që kom plotësu dy funksione.

Pas universitetit, siç thashë, u themelunë edhe fakultete tjera, por unë tu qenë si prorektor, 1970 kom themelu Fakultetin e Xehetarisë dhe Metalurgjisë. Fillimisht me seli në Prishtinë pranë Fakultetit Teknik, kurse pas dy vjete osht' transferu fakulteti në Mitrovicë. Në Mitrovicë se aty kishte vendin Gjeologjia, Xehetaria, Metalurgjia e Teknologjia. Edhe aty kom qendru në dy mandate si dekan, si dekan dhe si anëtar i Komisionit Amë për themelimin e atij fakultetit nji vit.

E pastaj përse jam kthyer në Trepçë? Në 1978 jom kthy në Trepçë, kom punu përsëri ri-themelimin e Universitetit, po në baza tjera... të Institutit të Xehetarisë, Institutit të Plumb-Zinkut e kem qujtë ashtu, po në baza tjera, si institucion shkencor. Ai që u themelu në '65-tën nuk ishte fort edhe shkencor, në baza shkencore sipas ligjit për veprimtarinë shkencore. Dy vjet, mas dy vjete mas demonstratave të...

Erëmirë Krasniqi: '68-tës...

Minir Dushi: '81-shit, '81-shit. UK [Universiteti i Kosovës] ishte aktuale me marrë një njeri nga prodhimi me bo rektor aty.

Erëmirë Krasniqi: Pse, a mundesh me na tregu qet' pjesë?

Minir Dushi: Se shkencat shoqërore ishin, ishin forcu shumë, e politika donte me i stopu ato. Donin prodhimin, ma shumë prodhimin. Edhe mu më kanë caktu rektor i Universitetit në '81-shin, në atë

kohën kur ka qenë koha ma e papërshtatshme, e randë, pas demonstratave të studentëve. Megjithatë, unë jom i knaqun se e kom kry atë detyrë me shumë sukses, me shumë sukses edhe pa telashe të mëdhaja, me përjashtu nga fakulteti profesorë e kështu asi... vetëm nja dy vetëve ju kemi ndërru vendet e punës, dhe të tjerë nuk kanë prekë hiç, qashtu ka qenë politika.

Kaltrina Krasniqi: Ku e keni, ku keni qenë gjatë Luftës të Dytë Botnore?

Minir Dushi: Gjatë Luftës të Dytë Botërore kom qenë në Kosovë, Kosovë, edhe kom qenë në organizatën e SKOJ-it, anëtar i SKOJ-it. E duke qenë anëtar i SKOJ-it, ndonëse isha mjaft i ri, as 15 vjeç jo, unë dëshirova të shkoj në rradhën partizane Bajram Curri në Malësinë e Gjakovës. Isha adoleshent, si thojnë ashtu, por kisha dëshirë edhe shkova.

Kom shku në Gri, fshati Gri, aty ka qenë Shtabi Operativ i Partizanëve të Kosovës, komandant Fadil Hoxha. Kom qëndru nja një muj, pastaj filloi ofenziva e dimnit si quhet, atëhere vinin gjermanët kundër partizanëve që ishin grumbullu shta... kjo, në Gri, bataloni i Bajram Currit në, edhe bataloni Perlat Rexhepi nga Shkodra. Ndërsa në Gri ishin grupi tjetër i partizanëve, pardon jo në Gri por në degë, por... ata ia msynë Malësisë, edhe tu qenë se une isha i ri, siç thashë 15 vjeç, Fadil Hoxha, komandanti i shtabit më fton, thotë, "Shiko, duhet të kthehet në Gjakovë..." Se unë kundërshtonja, "Jo, nuk kthehna në Gjakovë se du me nejt partizan". "Por shih," thotë Fadil Hoxha, "tani po vjen ofenziva, na nuk kemi forca me u përballu me ta, do shpërndahemi krejt. Prandaj ti duhet të shkojsh patjetër sot, se sot shkojnë një grup i partizanëve edhe kurriri për Gjakovë".

Atë ditë ka qenë moti pa borë, ka qenë mëngjes kur u bo kjo bisedë. Kur u bo ora 12:00 për m'u nisë grupi i partizanëve, ku ishte një Emini, ka qenë, i qujtur Emini, ka qenë kurriri kryesor. Ka qenë Petroviqi, një serb i Gjakovës, pastaj ka qenë Hysni Dobruna, kom qenë unë edhe një, nuk më kujtohet kush. Jemi nisë për Gjakovë edhe bora ka arritë deri qitu {prekë përmbi bark}. Unë kom pasë një shinjiel të vogël italian, ktu e maj në mend qikaq qe {tregon dy gishta gjatësi} akulli u pat bo n'to.

Kemi mërri në Ponushevc, e në Ponushevc ka qenë një bazë ku kemi bo natën, në të vërtetë ditën, se natën partizanët vetëm natën kanë lëvizë, e ditën jo. E kemi kalu ditën aty deri në mramje, në mramje jemi nisë për Gjakovë, i gjithë grupi. Kemi shku në Gjakovë, në Gjakovë kanë ekzistë disa baza të partizanëve, por une kom shku në rrugë të Çabratit i thojnë në shpinë e Ibrahim... Muhaxhirit, Ibrahim Muhaxhirit, aty ka qenë baza, aty e kom bo natën. Të nesërmin bora po ashtu, mu familja më ka kërku shumë. Baba ka ardhë edhe në Malësi atje me më marrë se isha fëmijë, tani e më hetojnë ku jonë edhe vijnë e më merr baba në shpi më çoi. Shumë telashe të madhe i kom nxerrë babës tim, *auu* {onomatope}, i kërkoj falje aty në librin tim e kom shkrujtë, po.

E tani axhallarët e mij, e baba e kishin një dyqan në Prishtinë, në Prishtinë, manofakturë, dyqani mirë, por që bënte shumë xhiro. Ata thanë, axha e baba, axhallarët e baba, po i çojmë në Prishtinë se atje nuk e njef kërkush. Edhe kom ardhë në Prishtinë këtu, kom jetu dy vjet...

Erëmirë Krasniqi: Ku e keni pasë dyqanin këtu në Prishtinë? Ku ka qenë?

Minir Dushi: Te shadërvani, te Çarshia e Mblune si i thojnë, shadërvani, do sheja të shadërvanit jonë edhe sot, te, përfundi, përfundi objektit të shtypshkronjës “Rezniqi”, me shku anej atje shihen asine, po. E këtu kom qëndru deri ‘45-shin a diçka, mandej jom kthy në Gjakovë sërish që kom fillu shkollën me kry, kur kryva semimaturën ato, shkova në Nish, ato që fola pak ma përpara.

Erëmirë Krasniqi: A munesh me na kallxu tash ktu ma shumë për Prishtinën edhe për jahuditë, se herën e kalume më kallxove që të kujtohet kur ka ardhë njësitë Skanderbeg edhe i ka deportu.

Minir Dushi: Eh, se harrova që i kom [i referohet mikrofonit]. Nji jahudi i quajtur Jak, ka punu në dyqan te na. Ai jahudia ka qenë i mirë shumë, por ktynehere ka qenë për me qitë mallin pak përjashta për m’i pa. I qitnin do shamia asi, kur vinin fshatarët e merrnin ato, “Sa o kjo shami mor?” “Kjo osht’ 100 lekë”. Ai thojke, “120 lekë”. “O Jak, pse i thu asi?” “Jena mësu, duhet me i thonë ma naltë e me ia lëshu çmimin”. Mandej e qitke 100 lekë (qeshë). Qishtu ka qenë origjinale, po. E kom e kom banu te jahuditë, në dy shpija të jahudive, njena sot osht’ ende hala ajo shpi, mirë do ishte me bo nji foto të saj, po osht’ afër bibliotekës, bibliotekës të qytetit, bibliotekës të vjetër...

Erëmirë Krasniqi: Hivzi Sylejmanit...

Minir Dushi: A tash Hivzi Sylejmani a?

Erëmirë Krasniqi: Qashtu ka qenë atëherë...

Minir Dushi: Po, eh nji aty asine, po biblo... shtëpia. Edhe e kom përjetu kur e kanë marrë jahuditë atë natë, kur i kanë mledhë, se unë kom qenë në shpi. Nji axhë i imi çdo të hane vinte këtu për pazar të martën, e të mërkuren në mëngjes shkonte në Gjakovë. Ishte edhe ai axha atë natë kur papritmas dera, ka qenë një derë me çekiç, vijnë i mshojnë çekiç, *dë, dë, dë* {onomatope}, s’e harroj edhe sot. Tani, po *bim... bom, bom bom* {onomatope} e rrëzojnë derën, edhe hijnë. Kur hijnë aty në korridor, axha doli përjashta, ata i thanë, “Hin mrena!” Ata ishin SS shqiptarë në të vërtetë, ai regjimenti...

Erëmirë Krasniqi: Skanderbeg...

Minir Dushi: Skanderbeg, po, e ata asine... e i murrën jahuditë krejt, metë shpija bosh, në pizhama si kanë qenë njashtu i kanë marrë. Metëm, ishte trishtim i madh ajo.

Kaltrina Krasniqi: Sa vetë kanë qenë?

Minir Dushi: Ajo familja nuk kanë qenë familje e madhe. Jo, i ka pasë tre, katër fëmijë, po, babë e nanë, asinë, po... njeni ka qenë mocanik me mu, një djalë, edhe ka tentu mu fshehtë, në arshihane aty dikun, e kanë marrë, e rrehen edhe si naj burg, a si naj...

Të shtunën jahuditë nuk dhezin zjerëm, e më kanë ftu mu gjithnjë të shtunën me ju dhezë zjarrin, furrën se ata nuk dhezin, po. Edhe baca Sallomon ka qenë njeni me mjekërr deri këtu {prekë barkun}, kur u çoke në mëngjes, e kapke biblën [tora] edhe, *bababababa* {onomatope}... Une e nijsha naltë, dhomën e kisha poshtë, nuk u nalke, veç kur hajke bukë, edhe kur bile me flejt, shumë trishtim ka qenë. Çka me ju thonë tjetër?

Erëmirë Krasniqi: A ki tregime tjera me jahudi për dyqanet e tyre, a keni pasë, a kanë pasë dyqane qaty ku e keni pasë edhe ju dyqanin e juj?

Minir Dushi: Po, si jo. Na... u kanë çarshia kryesore e Prishtinës. Une kom pasë kojshi, e kom pasë, i kom pasë këta vendasit e Prishtinës, Batallët, Qamil Batalli që u kanë i njoftun...

Erëmirë Krasniqi: Shkrimtar.

Minir Dushi: Si arsimtar, po, Qamil Batalli. Mbi të ka qenë një Shehi, mbiemrin Shehi, qeleshe kanë bo, gjakovarë kanë qenë, kanë bo qeleshe. Kurse në anën tjetër përfundi kom pasë po ashtu nga Gjakova ka qenë Jahja Dibra, Jahja Dibra, një tregtar me plotë kuptimin e fjalës, shumë i pregaditur. Karshi, karshi kom pasë serbë, një serb në të vërtetë, një njeri, një serb, zotni i madh i Prishtinës. Dy djem, shumë të kulturum e asinë, vajza e tyre ka qenë e martume për Dhimitër Folani nga Shqipëria, mësues nga Shqipëria, Dhimitër Folani, ai i njoftun ka qenë, po. E kështu ishin, përpjekje, përshendetëshim shpesh me atë, ia kom harru emrin, ai baba i këtyre djemëve, e asinë po ka qenë një njeri tregtar, shumë serioz asinë edhe...

Kaltrina Krasniqi: Ku kanë jetu jahuditë në Prishtinë? A e kanë pasë naj pjesë ku kanë qenë ma të koncentrum?

Minir Dushi: Jo, une nuk e di atë, po ka pasë shpijat e tyre, i kanë pasë, si me thanë... dy shpija i di une ku kom banu une, po... të tjerët nuk e di. Ka qenë edhe sinagoga atyne...

Kaltrina Krasniqi: Ku e kanë pasë?

Minir Dushi: Po qaty te... dëgjoni, e dini Çarshinë, e dini Xhaminë e Çarshisë karshi sejna krejt kanë qenë tregtarë, dyqane të gjitha. Ajo ku është tashti edhe përmendorja e...

Kaltrina Krasniqi: Vllaznim Bashkimit.

Minir Dushi: Po, po. E shumë dyqane ka pasë, jashtëzakonisht shumë se Prishtina ka qenë shumë vend tregtar edhe ka pasë shitje shumë të madhe të mallrave po. E qaty dikund do të ketë qenë sinagoga po nuk e mbaj mënd. Çka doni tjetër?

Erëmirë Krasniqi: Çka shitshi në atë farë dugojën e ju, a i shitshi qito zhgunat e kto...

Minir Dushi: Ja, zhgunat në Gjakovë...

Erëmirë Krasniqi: Po, e ktu në Prishtinë?

Minir Dushi: E ktu tregti manofaktura, ai dyqani ku e kishim ne. Po, po ka qenë ni ustah Faiki, pak ma nalt se dyqani im, ma nalt... ustah Faiki edhe ai ka qenë gjakovar, po i ardhun moti ktu që u marr me zhgunexhillëk i thojnë, me qep zhguna po shumë njeri i mirë asi, domethanë u shpërngul shkoi në Turqi. Edhe tash a po doni me iu thonë asine s'janë fort për kto. Shkova në Turqi me e kërku, përveç tjerave, me e kërku ustah Faikin. E më kanë thanë se ustah Faiki osht' në Bursë, në Bursë.

Une kom shku në Bursë edhe në qendër aty jom parku, jom dalë jashtë jonë mshef do fmi po flasin shqip ndër veti. "Nal more fmi, çka jeni?" "Na jemi shqiptarë". "Po, po, ku?" "Ktu banojmë asi..." Njoni prej tyre ishte ma i rritun. Thashë, "Jom kah e lypi ustah Faikin, a keni ndëgju për to a jo nuk keni dëgju". "Valla..." tha, "jo po të çoj te ni dyqan të prishtinalive e ai mund ta dijë". "Hajde pra". Shkon ai, vjen më shoqëron mu, shkojmë deri te qai dyqani. Kur nalt... ajo Bursa është si e hapur... nalt ai po i thotë, u prezantova e po i njof ata e ishin kta të Gjilanit, në të vërtetë ata janë të Gjilanit. Shumë të njoftun.

Dy-tre profesora të familjes të tyne i kemi pasë në Fakultetin Teknik që momentalisht s'po më kujtohet mbiemri, Nexhat Orana, te Oranat, dyqani i Oranave po. Pasi tha ai, "Valla..." thotë ai, "sa e di une ustah Faiki nuk është ktu po është në Stamboll". "Po atje s'e gjeta". Tash ky djali që erdh po më thotë mu, "A keni dëshirë me iu shoqëru pak me i pa kto mazoletë e osmanlive? Jom gati me asi..." "Po". "Hajde".

Shumë impozante ato, osmani i parë ato krejt ishin aty tyrbet e mdhaja, jashtëzakonisht impozante. Po edhe, po ma... po shkon, unë jom kanë me bashkëshorten, ai djali. Po kur shoh përmas vinin do fmi. Me ni rast u ulëm dikund me pushu, kur ata fmitë të-të-të {onomatope} "Po na jemi shqiptarë, po ju përciellim se po flisni shqip," po, e tjera e tjera.

Erëmirë Krasniqi: Kjo osht' me atë shpërnguljen e të '50-tave të shqiptarëve në Turqi, domethanë ni pjesë e tregtarve ka shku në qat' kohë.

Minir Dushi: Po, po, po. Asokohe shpërngulja ka qenë... sidomos në '56-tën, do kusheri të mitë që kanë jetu ktu, u shpërngulën shkunë në Izmir, në Izmir. Une shkova për ata me i vizitu edhe e lypa këtë

ustah Faikin që e përmenda asi. Edhe ka pasë mjaft të Prishtinës në Izmir, shumë familje që janë... atëherë kur janë shpërngulë me dy-tre trena natyrisht, por s'kanë mujt mallin me e marr me veti. Shpinë, ni shpi kanë mujt me shitë, tjerat me i lanë ktu. Qashtu ka qenë.

Erëmirë Krasniqi: E qysh u kthytë mandej në Gjakovë? A po doni me shku në Gjakovë, a me nejt me na spjegu ende për Prishtinë?

Minir Dushi: Aha, jo e thashë ata.

Erëmirë Krasniqi: A mundesh me na tregu edhe ma shumë për qit farë tregun, për qat' pazarin e mlutë ku ka qenë?

Minir Dushi: Çarshia e Mlune...

Erëmirë Krasniqi: Çarshia e Mlutë, më fal.

Minir Dushi: Çarshia e mlune qaty ka qenë, edhe kanë qenë tregtarë pak qaty ma... Kapali Çarshia që i thojnë turqisht...

Erëmirë Krasniqi: Kapali.

Minir Dushi: Çarshia e Mbyllun, e Mbulune, Çarshia. Po aty ka pasë mjaft dyqane.

Kaltrina Krasniqi: A mundesh me na kallxu qysh ka ndryshu qyteti prej atëherë?

Minir Dushi: Une e mbaj në mend mirë Prishtinën edhe di shumë shenja ku ka qenë e vjetra, e u ardhë e reja, shumë. E ndryshimet janë rrënjësore. Ajo ka qenë ni kasaba turke, po pak e zhvillune, bukur e zhvillune po... kurse kur erdh koha e zhvillimit tonë ajo ndryshoi rrënjësisht, këto objekte që janë. Te teatri ku osht' aty ka qenë ni xhami pa minare, po, karshi aty e mbaj në mend kanë qenë, e mbaj në mend kanë jetu Hoxhaxhiktë, ata të njoftun, familje e njoftun Hoxhaxhikët në Prishtinë, tregtarë të mëdhej asi. Kurse qiky objekti që osht' që u prish e u rregullu tash, "Unioni" që po i thojnë...

Erëmirë Krasniqi: "Unioni", po.

Minir Dushi: Ai ka ekzistuar atëherë, ka qenë, ka qenë kinema. Unë aty kom pa disa herë, disa filma i kom pa aty...

Erëmirë Krasniqi: A s'ka qenë bujtinë ajo gjithë a?

Minir Dushi: A?

Erëmirë Krasniqi: A s'ka qenë gjithmonë bujtinë a?

Minir Dushi: Po, bujtina nalt, po salla e ato asine...

Erëmirë Krasniqi: A poshtë.

Minir Dushi: Po, po. E kanë qenë dy vllazën Shasivari, ata thonin e kanë të vetën këtë objekt. Kanë qenë njerëz jo fort se janë marr me... kanë, kanë bashkëpunu me okupatorin. Nuk e di fundin e atyne çka u bo.

Kaltrina Krasniqi: E kto pjesët tjera mandej?

Minir Dushi: A?

Kaltrina Krasniqi: Kto pjesët tjera...

Minir Dushi: Objektet tjera krejt janë hjek, asnjë s'e di aty që osht'... ja asni. Qaty ka qenë korza, e mbaj në mend mirë korza, po ka qenë ni librari e mbante ni dhondërr i jemi pak ma i largtë, i Shllakëve prej Gjakovës, në Kukës jeton ai, në Kukës, në Kukës. E mbaj në mend atë, atë librari...

Kaltrina Krasniqi: Ku ka qenë?

Minir Dushi: Po ka qenë Çarshia qajo kryesore, jo Çarshia, rruga kryesore, rruga kryesore po e, e kom shkrujtë qitu... rruga... Prishtina, rruga UÇK më doket tash osht' ajo osht' e vjetër qysh ka qenë edhe objektet janë ndërtu anash. Ajo osht' thirrë rruga e Divan Yolit, rruga e Divan Yolit, pse? Se anej ka shku mbreti u kanë Sulltan Hamiti i II-të, ka ardhë këtu vizitë në Kosovë me e hap medresen, në të vërtetë unviersitetin islamik, ajo ndërtesa ku osht' sot...

Erëmirë Krasniqi: Ministria e...

Minir Dushi: E Shëndetësisë, në atë kohë osht' maru ajo, ajo osht' objekt i Turqisë, e ka hapë edhe ka kalu anej ka rruga Divan Yoli i kanë thanë, Divan Yoli prishtinalitë e vjetër qashtu i thojnë asajna.

Erëmirë Krasniqi: E ku ka qenë qendra e Prishtinës në atë kohë?

Minir Dushi: Qendra e Prishtinës ka qenë ku osht' ktu përfaqësisht tash ku osht' teatri ajo aty e te poshtë shkonte rruga kryesore që mun e sheh shitorja, i sheh shitorët ato që... gjithkund me traditë aty shëtisin ku osht' rruga ma e mirë në qytet, ja në Prishtinë, në Gjakovë, e në Mitrovicë, Prizreni shadërvani e asina po. E ajo ka qenë aty...

Erëmirë Krasniqi: E sot aty ku universiteti edhe katedralja...

Minir Dushi: A?

Erëmirë Krasniqi: Ku osht' Lakrishtja çka ka pasë në atë kohë?

Minir Dushi: Ku knena ka universiteti?

Erëmirë Krasniqi: Po, anej kah universiteti çka ka pasë?

Minir Dushi: Anej janë kanë kazermat. Kazermat kanë qenë hyrja, ka qenë po ktu ku jemi na gati, ka qenë hymja, ni hymje për kazerma. Kurse ku osht' rektorati aty, aty kanë nejt rojet, ushtarakët, a po kupton?

Erëmirë Krasniqi: E çfarë ndërtese ka qenë ajo e rektoratit përpara?

Minir Dushi: Nuk e di, ushtarake por qajo osht' sot veç i kemi ndërtu, kom pasë nderin une me i ndryshu ato bukur asine po. Edhe krejt hapësina ku e zen universiteti kanë qenë kazerma. Une kom hi si fmi disa herë në kazerma, tinëz, se e kom pasë ni axhë timin në llogor. Axhën time e patën marr llogor si partizan edhe i ka ndihmu partizanët edhe ka qenë... unë shkojsha me i çu bukë e diçka asine. Kto janë biseda shumë të largta. Aty ka pasë, mandej kanë ardhë prej Shqipnie i kanë pru nja njiqind e sa të burgosur partizanë i kanë pru në llogor të Prishtinës. Ata i kanë pushkatu ktu, ajo osht' shenja atje kur i kanë pushkatu ata të gjithë.

Kaltrina Krasniqi: Ku?

Minir Dushi: Te Institui i Historisë që osht' bo, e aty, e aty osht' shenja, osht' ni përmendore e vogël te... aty...

Erëmirë Krasniqi: Ju atë ditë më tregutë që edhe edhe jahuditë i kanë pushkatu aty në Taukbahçe për qata...

Minir Dushi: Jahuditë, kur i kanë marr jahuditë, disa jahudi. Ka qenë ni Buk jahudia, Buk jahudia ka qenë i pasun, thonin që ka dhanë pare aty dhe e kanë marrë e kanë pushkatu aty te vorret e jahudive.

Kaltrina Krasniqi: Çka ka ndodhë me pronat e jahudive kur i kanë marrë?

Minir Dushi: Nuk e di, nuk di shumë disa kanë shitë e disa ku ta di une, veç pjesa dërmuese kanë mbetë njëashtu. E tash po iu thom edhe ni gjo para njo shtatë-tetë vjete erdhi ni jahudi prej, prej Izraelit, ai kishte qenë jahudi i...

Erëmirë Krasniqi: Prishtinës?

Minir Dushi: Jo, jo, i, i, i Sarajevës, i Sarajevës. Edhe dikush i ka thanë që unë jom inxhinier i minierave, kom punu në miniera kështu e asi, edhe e bijnë te une. Thotë, “Unë jom ardhë. Jom... qishtu qishtu qishtu, jom ardhë te vorret e jahudive ku kanë qenë në Novobërdë” “Vallahi,” thashë, “nuk e di, nuk e di”. Ama manej kom ni i kanë gjetë do vorre të gata nuk thirren vorret e jahudive, po vorret e kaurrive, vorret e kaurrive u thirrkan i ka gjetë të nesërmen (qeshë).

Erëmirë Krasniqi: A mujmë...

Minir Dushi: A i dini kto fotografitë? A i dini qato që i keni marrë?

Erëmirë Krasniqi: Po, po e dijmë.

Minir Dushi: Njana osht’ 12 vjeçe, njana osht’ 18 vjeçe, e ktu që i keni aty ma asi po...

Kaltrina Krasniqi: Edhe ni pytje për qat’ periudhën e fëminisë të juj...

Minir Dushi: Periudhën e?

Kaltrina Krasniqi: Fëminisë, kur keni qenë fëmijë.

Minir Dushi: A fëminisë.

Kaltrina Krasniqi: Në Prishtinë. A ka pasë gra në jetën publike?

Minir Dushi: A ka pasë?

Kaltrina Krasniqi: Gra.

Minir Dushi: Gra?

Kaltrina Krasniqi: Në jetën publike.

Minir Dushi: Jo, jo, nuk më kujtohet. Mund të iu them edhe ni gja, pak si e ngjashme me kta... më fal se, a osht’ në rregull? Erdh te na ni myshteri në dyqan, u gutke diçka, “Po pse po gutesh?” “A din ku ka

me shku?” “Ha?” “Te mullini i Shyqeri Begut”. “O mullini i Shyqeri Begut...” Ajo u kanë larg demek *he* {onomotope}. Prej dyqanit tim deri te mullini i Shyqeri Begut, a din ku ka qenë? Qitu te, ku osht’ ProCredit Banka, në qendër qitu, qaty do shenja hala mullini i Shyqeri Begut. Aty u kanë skeji i Prishtinës, skeji i Prishtinës, “A din ku ka me shku te mullini i Shyqeri Begut?” “Aiiiiii ku paske me shku...” (qeshë).

Kaltrina Krasniqi: Okej.

Erëmirë Krasniqi: E qysh e ka pasë emrin dyqani i juj? A ka pasë naj emër?

Minir Dushi: Jo, dyqan manufaktura. Ajo bile as mbiemrat nuk i shkrunin atëherë se me thanë, po e dishe. Ky o dyqani i Batallve, kjo osht’ dyqani i Jahja Dibrës, kjo osht’ dyqani i Beg Dushit, a po kupton, ai dyqani i qelsh-punuesi...

Erëmirë Krasniqi: A ka pasë këpucëtarë?

Minir Dushi: A?

Erëmirë Krasniqi: A ka pasë këpucëtarë aty?

Minir Dushi: Jo, ktu u kanë Çarshia e sistemune. Në çdo qytet të kohës së Turqisë ka qenë e sistemune. Për shembull, në Gjakovë ka qenë zhgunaxhitë, kallajxhitë, qelshxhitë, manufaktura, krejt janë kanë të caktune asine.

Kaltrina Krasniqi: E çka osht’ manufaktura?

Minir Dushi: A?

Kaltrina Krasniqi: Çka ka qenë?

Minir Dushi: Manufaktura shitet me metër, me metër...

Kaltrina Krasniqi: A materiali, shtofna e kto...

Minir Dushi: Po, shtofa e kto, ni manufakturë qashtu.

Erëmirë Krasniqi: E prej kahit i merrshi ju shtofat?

Minir Dushi: Italia, aso kohe ishte Italia ktu. Binin mall prej Italisë shumë, ka pasë shumë mall në Shqipëri prej Italisë *auuuu* {onomotope} mall edhe të lira edhe të mira.

Kaltrina Krasniqi: A u tutshit prej italianve?

Minir Dushi: Jo, jo, prej italianve jo. Kanë qenë të butë, njerëz të butë ata.

Erëmirë Krasniqi: E qysh u pjekën kushtet me shku ju prapë në Gjakovë? Kur e dishit që jeni të sigurt me u kthy tash mas?

Minir Dushi: U maru... shikoni kur erdhën patizanët atje s'kish tregti, u mshel krejt, e merrnin mallin e krejt. Ktu nuk kisha fort çka me nejt ktu, thashë shkoj në Gjakovë vazhdoj shkollimin se s'ka perspektivë tjetër. Jo, na tradicionalisht jemi marrë me tregti, por u pa që ma ajo punë duhet të vdesë me u marr me shkolla me u shkollu. E unë kom arritë qashtu me u shkollu, maksimalen e kom arritë. Qashtu qe. A keni diçka tjetër çka muj une me asi?

Kaltrina Krasniqi: Po mundemi...

Erëmirë Krasniqi: Po, muj me iu pytë nashta qysh ka qenë në atë kohë, po menoj ka ndrru stili i jetës plotësisht prej tregtisë në edukim. Qysh ka qenë qajo jetë e re, se edhe ni shtet i ri, ka ndrru...

Minir Dushi: Atëherë ka qenë, ka qenë orientimi jetësor ka qenë me punu me tregti e me kafe kafallarë, ku ta di une asine ose tregti, me tregti a kupton? Po, e qe sot osht' krejt ndryshe, diametralisht e kundërt. Unë maj në mënd ni gjo në Gjakovë, Haki Taha, e dini kush ka qenë Haki Taha, a e dini?

Erëmirë Krasniqi: A ka qenë...

Minir Dushi: Ai që e ka myt Milladinin.

Kaltrina Krasniqi: Milladin Popoviqin.

Minir Dushi: Po. Ai ka qenë msus i imi në Gjakovë po ka qenë shumë njeri, natyrisht, patriot edhe arsimdashës. Unë mbaj në mend ai në Gjakovë i mledhke kafallartë krejt e kapuqa të bardhë qelesha e dilshin për festa. *Eiii* {onomotope} shumë gjana ka ktu për t'u folë, por nuk di a po muj une me iu ndihmu une najsen apo jo, s'e di.

Erëmirë Krasniqi: Po, po, shumë. Shumë faleminderit. E qysh ka qenë jeta në Gjakovë mandej kur u kthyte, veç tregime kallxoni se qashtu thjeshtë...

Minir Dushi: Në Gjakovë, në Gjakovë ka qenë edhe atje vendi i tregtisë, po shitjet kanë qenë në Prishtinë, domethanë xhirotë janë bo ma të mdhaja në Prishtinë ktu. Në Gjakovë osht' punue për me

jetue. Kanë qenë një mijë dyqane në Gjakovë, Çarshia, Çarshia e Madhe, Çarshia e Vogël asine, por kanë qenë shumë... të njohura, njohura. Si thashë, kanë qenë të sisteme. Manufaktura ktu, kto zanatet e tjera ktu të gjitha asine. Interesant osht' që të gjithë serbët e Gjakovës janë marrë me, me... kanë qenë të inkudrunë në si zanatlinjë. Janë kanë të gjithë serbët janë kanë teneqexhinjë, kallajxi, opongaxhi... me tregti s'janë marrë ata.

Kaltrina Krasniqi: Pse?

Minir Dushi: Se s'ka pasë. Kanë qenë një dy shpija të mdhaja që janë marrë me tregti... si thashë, opongaxhi, katër asine, qito janë edhe kafexhi, kafexhi. Me ato janë marrë serbët në Gjakovë, por ka pasë shumë pak serbë.

Erëmirë Krasniqi: E familjen qysh e gjetët?

Minir Dushi: A?

Erëmirë Krasniqi: Familjen qysh e keni gjetë kur jeni kthi në '45 ose '46 në Gjakovë?

Minir Dushi: S'kom pasë problem une, a asi në çfarë gjendje?

Erëmirë Krasniqi: Po çfarë gjendje, qysh...

Minir Dushi: Në gjendje të mirë. Ata janë marr me tregti, po pastaj ia nisën...

Erëmirë Krasniqi: Nuk ka pasë viktima gjatë Luftës të Dytë?

Minir Dushi: Jo, viktima jo, por erdhën partizantë atëherë, parimet janë kanë s'ka ma, kta janë kapitalista merr mallin merr asine, e kanë marr krejt mallin. Po si doli ajo, që thojnë populli manej, "Na murrën pushkën, na dhanë topin partizanët", domethanë shkollimin, shkollimin. Na murrën krejt kto, por na dhanë, na dhanë topin, shkollimin, u shkollum të gjithë asine, ishte shumë progresive.

[Pjesët në vijim të intervistës janë realizuar më 24 nëntor, 2022]

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: Zotri Minir, nëse mundeni me na tregu diçka për prejardhjen e familjen e ju?

Minir Dushi: Po mund t'ju thom, une rrjedhi nga një familje e vjetër autoktone gjakovare, me emnin Beg Dushi, sigurisht diku nga Dushi fshat, pastaj ka qenë me gradë ku ta di une në kohën e Turqisë,

ushtarak Beg a ku ta di une ashtu dallon familja Beg Dushi. Është shumë e njohun në qytetin e Gjakovës e rrethinën e saj. Kjo familje është marrë me zhgunaxhillëk, qysh i kanë thanë përpara, përpunimin e zhgunave, harkave, tirqive, bulera, e tjera, familje tradicionale. Në Gjakovë kanë qenë shumë familje që janë marrë me qepjen e zhgunave, Çarshinë e Madhe e në mahallën Muamedi, kanë qenë më shumë se 20 dyqane që janë marrë me tirqi, harka, zhguna, ku ta di une ato s'e kam pa.

Ne ishim familje e madhe se ishin gjashtë vllazën. Babai i im i ka pasë edhe pesë vllazën, domethanë gjashtë bashkë me të. Të gjithë janë marrë me këtë zeje shumë të suksesshëm dhe të trashëgume nga gjyshi, nga gjyshi Mehmet Beg Dushi i qujtur. Pasi ishin të rinj vllaznit, axhallarët e baba e asine kishin arritë bukur ni kapital. Pastaj fillon ta menjanojnë pakëz zejen e zhgunave të merren edhe me tregti. E hapën një tregti shumë të madhe, aty axhallarët punonin. Kanë punu me shumë sukses, e janë afirmu në Gjakovë si dy për një, ishin familje e madhe.

Unë asokohe në Gjakovë kur erdhi koha për shkollim, nuk po flas për shkollën fillore e ato normal asi në Gjakovë, por pastaj duhet të shkollohem ma tutje në shkollën e mesme e mandej ma lartë edhe babai im i ndjerë na ka përkrahë këtë koncept gjithsesi. Megjithëse, kjo ishte viti 1946 kur u bo edhe çlirimi, para mbarimi i Luftës së Dytë Botërore. Unë asokohe e krynja shkollën, gjimnazin e ulët u quhke semimatura dhe tani duhet të shkosh në shkollë të mesme. Në vitin 1946 u themelu në Gjakovë Shkolla Normale, historike, një shkollë madhore, shkollë që ka lujt rolin e njejtë të Normales së Elbasanit, krejtësisht njejt, të njejtin rol.

Në atë kohë, në '46-shin, nevoja për mësues ka qenë e jashtëzakonshme, nuk ka pasë mësues. Kanë mungu mësuesit edhe parimet, edhe të asaj kohe parti e kështu, ishin që gjeneratat qi e kryejn, sikur tashti nëntë, nëntë-vjeçaren ashtu, komplet duhet të regjistrohenin në Shkollën Normale. Nga Prizreni kanë ardhë, nga Gjakova, nga Peja por edhe natyrshëm nga Gjakova, e besa kanë ardhë edhe nga Mali i Zi atje asokohe qi janë regjistru në Normale. Por, une me gjithë një shokë tjetër nuk donim Shkollën Normale, donim diçka tjetër me mësu, edhe kundërshtum, po nuk u pranu mirë ai ndryshim. Megjithatë, ai ishte shumë i dobishëm për më vonë (qeshë).

Anita Susuri: A kanë qenë prindërit e juv kundër qasaj që po doni me vazhdu, prind apo kush ka qenë kundër?

Minir Dushi: Kundër, një njeri Beqir Kastrati ishte drejtor i shkollës ulët të asaj kohe, tashti ai po bohet drejtor i Normales. Edhe ni herë, "More Minir, po pse ti nuk do? Po ti je i lindun për mi kështu më thotë. I lindun për mësues, po mirë, po po duan të gjithë të bahen mësues e mësuese, diçka ndryshim edhe unë edhe një shok i imi shkum u regjistru në Nish në Shkollën e Mesme Teknike - Elektroteknike. Ajo ishte një shkollë shumë serioze, shumë me traditë. Na, unë personalisht s'e disha asnjë fjalë serbisht, asnjë fjalë serbisht, asnjë fjalë. Dalëngadalë e mësova gjuhën e kryva atë shkollë me mjaftë vështirësi edhe ekonomike, jo pse mungonin të holla e ashtu, po nuk kishte bukë atëhere, bukë nuk... u duhke

me hangër atje me triska², ushqimi me triska krejt. Edhe na ishim familje 27-8 anëtarsh në Gjakovë, ata s'kishin për veti e me m'çu mu, kjo ishte një krizë shumë e madhe.

Anita Susuri: Këto ishin vitet pas luftës '50-tat ?

Minir Dushi: Po atëherë ka qenë mungesa të mëdha të ushqimeve e gjithçka u kan triskëtim³, po dilnja rugës në Nish, i shihnja njerëzit, burra para derës të ulun duke thanë. “Ju lutem a mos e keni një copë bukë”. Singerisht kështu ka qenë, s'kishin edhe ata bukë. U revoltoshin e shajshin pushtetin, qysh mos me pas bukë edhe u shfryhnin ata natyrisht. Nuk e dishin a jam shqiptarë a çka jam, po që jam shqiptar. “*Srbija hoće hleba*” [srb.: Serbija dëshiron bukë] ata ashtu piskatshin (qeshë). Edhe u kry shkolla ashtu siç u kry, por edhe ato kuadrot e shkollave të mesme që i kryenin asokohe për shkak të mungesës së madhe të kuadrove, edhe në Jugosllavi veçantë te na lista e nxënësve që e kanë kry shkollën e mesme shkonte në Ministri.

Konkretisht kjo e shkollës sime shkon në Ministrinë e Jometaleve. Ministria e Jometaleve, kjo tash pak ma profesionale por qeto i ka, në xehetari i ka metale, jometale, kaosfobiolite, ku ta di unë tjera asine. Edhe ata caktonin kush ku me shku me punu, mu më caktuan në Golesh, në minierën e Goleshit. Aty takimi i parë i imi me minierat, se minierat, puna në minierë ashtë punë me traditë qi trashëgohet dhe familja ime s'kishte lidhje me ato sene absolutisht.

E njëherë në Golesh kam punu një vit, vitet tjera nuk kishte fort kushte aty dhe më lejun une kalova me punë prapë si mësues, që i ika mësuesisë, prapë si mësues shkova në Zvečan në Shkollën Industriale. Shkolla Industriale ishte një shkollë e mjeshtërive të Trepçës. Trepça financonte edhe ishte një shkollë shumë serioze, e kam këtu një fotografi {afrohet ta merr fotografinë}.

Anita Susuri: Ëhem, e shikojmë pastaj.

Minir Dushi: Kujtoma se e harrojmë.

Anita Susuri: Po.

Minir Dushi: Aty ishin serbë, serbisht krejt, por u gjetën tre gjakovarë. Une, domethanë Minir Dushi {numëron me gishtërinj}, Gjergj Shita dhe Basri Arapi apo Basri Agolli, tre mësues që hapëm paralelen në gjuhën shqipe edhe i marrim ne autorët shqip. Dhe dy vjet aty punonja, pastaj u vendosa me shku në studime. Çka do të studioj, më thojnë ka qenë në Gjakovë te na miniera e Devës, miniera ajo një bursë mund ta jepte me shku me studiu për xehetari, miniera.

² Fletë e vogël, e ndarë në lata, ku shënohet sasia e ushqimeve, e druve, e qymyrit, e artikujve, etj.

³ Sistem i shpërndarjes së disa mallrave në sasi të caktuara për çdo njeri a familje.

Anita Susuri: A ju ka tërhek qajo, a qysh ka ardhë deri te qajo që ju me përzgjedh për shembull, atë lloj industrisë?

Minir Dushi: Jo, jo. Nuk e di, spontane ka ardhë ajo. Dikur çka me regjistru, çka me asine? A di si të rinjtë që pyetnin asokohe po ku të regjistrohna, çka me asi, cilën a? Edhe unë mendonja me viju atë shka kom krye shkollën e mesme, Shkollën Teknike - Elektro me shku në Fakultetin e Elektro-Teknikës, por miniera jepke bursë vetëm për xehetari. Um pyetshin te tanë po çka ashtë kjo xehetaria ma? Askush nuk dike en Gjakovë, e Pejë, e Kosovë, çka ashtë xehetaria? Ai profesion i cili ishte ma së shumti i nevojshëm për Kosovën për shkak të pasurive të jashtëzakonshme të territorit, sot të Republikës së Kosovës. Dikush dike me thanë, po a di bre shka o ajo, po mademet⁴ bre, mademet që i nxjerrin në Trepçë me atë tjerresin. E dhe unë shkova në Beograd dhe u regjistrova në Fakultetin e Elektro Teknikës, degën që kisha.

Kur e morra vërtetimin {merr në dorë një letër} e çova në Devë. Ata thanë, “Na për këtë nuk japim bursë, në qoftë se ju nuk kaloni në xehetari bursë nuk ka”. “O-ho, po deshka xehetaria”, as vetë s’e kisha të qartë shka ashtë ajo, shka asi? U detyrova me ndrru fakultetin me u regjistru në xehetari, viti 1953-54, te fakulteti regjistrova në Fakultetin e Xehetarisë - Gjeologjisë, të Universitetit të Beogradit. Aty gjenerata ime ishte rreth 150-të studentë krejt, gjeologji e xehetari e pastaj disa specializime të tjera. Kështu që, ma në fund në vitin 1958 arrita m’i kry Fakultetin e Xehetarisë e tani jam inkuadru në punë si inxhinier i xehetarisë.

Këtu të ju thom, sa kom qenë si absolvent vitin e katër të studimeve, kur Gjakova ma ndërpreu bursën. A, atje ishte një fushatë, ishin do njerëz të kqij qi bënin shumë të kqija. Thanë, “Ky ashtë djalë i kapitalistave dhe këtij s’mun m’i dhanë bursë”. Megjithëse une isha kanë partizan, ma ndërpreu. Por çka të bëjë, ku të kërkojë një bursë? P’e kërkoj në Trepçë një bursë edhe ata ma dhanë bursën. E kom kërkua bursë më përpara në minierat e Serbisë, qymyrit sidomos, të gjitha ma kanë dhanë bursë dhe m’kanë lutë me ardh, por unë... thamë, “Hajt mor ta kqyri edhe në Trepçë atje”, po ata ma dhanë bursën edhe u bana bursist i Trepçës. Kështu që, kur e kryva në vitin ‘58 Fakultetin e Xehetarisë e Gjeologjisë në Beograd u inkuadrova në punë në minierën e Trepçës. Ky tash është një moment historik.

Anita Susuri: Zotri Minir, para se me vazhdu te Trepça po du prapë me u kthy, e përmende që keni qenë partizan, pjesë e Luftës së Dytë keni qenë. Po, po më intereson edhe ky... kjo pjesa para fillimit të Luftës, qysh e kujtoni ju krejt qatë periudhë?

Minir Dushi: Para?

Anita Susuri: Po, para, pastaj fillimi i luftës, qysh ka qenë krejt situata? Qysh është zhvillu? Qysh e keni pa ju si dëshmitarë i kohës?

⁴ Madem - mademet. Mineral, madem i rrallë.

Minir Dushi: Atëherë ishin në Gjakovë ishte Lëvizja Nacional Çlirimtare shumë e zhvillume. Edhe isha unë isha i inkuadrun në të ashtuquajturën SKOJ - Organizata e Rinisë Komuniste e që ishte në Jugosllavi, e prej aty pastaj duhet të kaloj me u ba ushtar partizan në Malësinë e Gjakovës. Edhe ashtu ngjajti, shkova atje, ajo është një... një, një situatë që krijuan familjet jashtëzakonshme tanë.

Anita Susuri: Pse?

Minir Dushi: Pse baba im dhe axhallarët ishin bukur të pasun dhe i bënin presione, “Djalë e ki partizan, ma jep këto, e këto, këto, e këto”. U trazuan tërë familja jashtëzakonisht shumë. E kur nuk di ma ma tutje, histori tjetër është ajo. Po edhe vij në Trepçe, minierën e Trepçës e kanë zbulu dhe e kanë hapë britanikët në vitin 1930. Ashtë prodhu xehoret e plumb-zinkut që kanë qenë shumë të pasuna, shumë, shumë të pasuna edhe kanë pasë edhe metale të tjera shoqëruese shumë me vlerë të madhe financiare. Shoqëruse aty...

E kështu që, Trepça punonte shumë atëherë. Ishte e njohun Trepça, e njohun shumë. Po e gjithë fuqia punëtore e krahut ishin shqiptarë, inxhinierë, nuk dilnin dikush me mendu që mund të ketë inxhinierë shqiptarë. A është e mundur m'u kanë? Por, nuk zinin besë që ka edhe inxhinierë shqiptarë. Dhe unë në zyre si jeni të ardhun ju këtu [i drejtohet intervistuesës], vinin e çelnin derën me pa si duket inxhinieri shqiptar. Pse? Ishin mësu ata gjithnji inxhinier britanik, gjerman, pastaj vinin slloven, serb, malazez, e gjitha nacionaliteteve tjera, e nuk mund imagjinonin të ketë një inxhinier i minierave shqiptar, e kështu që është një histori e veçantë ajo qështje aty.

Anita Susuri: E a dini ju diçka për një grevë që ka ndodh në '36-ën?

Minir Dushi: A, si urdhnon. Ajo greva e parë e minatorëve të Trepçës, gjatë... sundimit.

Anita Susuri: Kur kanë qenë britanezët.

Minir Dushi: Sundimit të britanikëve minierën, minierën. Po kanë qenë një... një demonstratë e madhe asine asaj kohe por ka lanë disa vraga, edhe ajo ka lanë do pasoja, do historike që përmenden mandej në vitet ma të ashpra që vinin si greva, e greva e minatorëve, po ajo grevë e minatorëve nuk mund të krahasohet aspak me grevën e minatorëve të vitit 1989, ajo është diçka tjetër.

Anita Susuri: Kjo ka qenë m'duket për kushte të punës, a për çka ka qenë?

Minir Dushi: Ato për pagesa dhe kushtet e punës normal, kanë qenë kushtet e punës shumë të rona. Po, këtu a din nuk ka pasë, miniera nuk ka qenë e mekanizime, çdo gja ka qenë me krah e punume. Nxjerrja e xehërorit, ngarkimi, shkarkimi, transporti, me krahë i kanë shty vagonat njerëzit. A, vonë është modernizu shumë miniera e Trepçës. Shumë, shumë tjetër, sot ka nivel botëror, por asokohe

ishite ndryshe. E kështut pra, unë punova në Trepçë minierë, minierën e Stantërgut katër vjet gati. Një ditë duke qenë poshtë në minierë, thërrasin nga drejtoria. A keni qenë ju ndonjëherë? [i drejtohet intervistuesës] Jo, nuk keni qenë ju.

Anita Susuri: Në Mitrovicë është apo [drejtoria]?

Minir Dushi: Jo, jo, në Stantërg.

Anita Susuri: Po, po.

Minir Dushi: A keni qenë?

Anita Susuri: Kemi qenë, po.

Minir Dushi: Eh, miniera poshtë, a drejtoria ka qenë nalt atje. Unë isha në minierë, n'thellësi në katin e shtatë a ku ta di une, edhe um thirrin nga drejtoria, "Shok inxhinier, jeni poshtë po? Po kanë ardhë disa, nja dy shokë kanë ardhë nga Këshilli Ekzekutiv i Kosovës e dojnë me bisedu dishka me ju". E pranoj, tutem me u ba gati me dalë me ardhë ka, po çka kanë ata me mu, unë një inxhinier i minierave. Përgaditem dal jashtë, kur shkoj në drejtori aty kishte ardhë përveç tjerëve Kolë Shiroka. Kolë Shiroka ka qenë sekretar i... seksionit, i arsimit, shkencës dhe i kulturës. Drejtori thotë, "Po shok Minir, po. Kam ardhë me bisedu me ty se dojmë me e hapë një Shkollë të Lartë Teknike, e me marrë përsipër ti me librin edhe udhëheqjen e shkollës". "Oh, po, po une hala jam i ri për ato punë more shok Kola". "Jo, jo".

Anita Susuri: Sa vjeç keni qenë?

Minir Dushi: 32 vjeç. U tuta une me lanë punën në Trepçe por si kuadër e Trepçës kjo është me randësi e veçantë. Edhe këtu si kuadër i Trepçës jam në Mitrovicë, jam... ka qenë shkolla teknike në Mitrovicë shumë e madhe është asi. Aty ma dhanë një krah për Shkollën e Lartë Teknike, Shkolla e Lartë. Du të them këtë tani, një degresion pakëz. Shkollimi i lartë në republikën, tashti ajo ishte në krahinën autonome të Kosovës ka fillu në vitin 1958, Shkolla e parë e Lartë është themelua Shkolla Pedagogjike, Shkolla e Lartë Pedagogjike në Prishtinë, e para. Pastaj, don me zhvillu shkencat teknike, formohen me 1961-shin u themelun dy shkolla të larta. Një ajo në Mitrovicë me dy seksione që i kishte, xehetari dhe kimi organike, kimi, teknologji. Dhe Shkolla e Lartë Teknike në Prishtinë nënseksionin elektroteknikë, ndërtimtari dhe metalurgji dhe, dhe...?

Anita Susuri: Xehetari?

Minir Dushi: Jo, jo, dhe makineri. Këto të tria. Këtu filluan për herë të parë në territorin në Kosovë që ka qenë mbrapania e paimagjinume asi, fillon edhe shkencat teknike të zhvillohen. Këtu ishte politika e tillë që më përpara të formohen Shkollat e Larta të aftësohet, të konsilodohen e të pasurohen, pastaj

të shndërrohen në fakultete. Mandej '60-shin tash fillon pra zhvillimi, zhvillimi i arsimit të lartë dhe universitar në krahinën autonome të Kosovës. Në vitin 1960 u themelu Fakulteti Filozofik, 1961 Fakulteti Juridiko - Ekonomik, 1965 Fakulteti Teknik, ajo Shkolla e Lartë që të tregova ma përpara, ajo u themelu u ngritë në Fakultet.

Anita Susuri: Fakultet.

Minir Dushi: Mandej fakulteti i Mjekësisë në 1949-tën..

Anita Susuri: '69.

Minir Dushi: A?

Anita Susuri: '69-tën, a '49-tën?

Minir Dushi: Ja, në '69-tën, më falni.

Anita Susuri: Aha, okej.

Minir Dushi: Në '60-tën, 1970-shin themelohet Universiteti i Prishtinës. Kështu që, këto ishin pra paraardhësit, institucionet e larta shkencore, fakultetet për mandej me e themelu Universitetin e Prishtinës.

Pjesa e Tretë

Anita Susuri: Deshta me ju pyet se ndërkohë kanë ndodhë demonstrata e vitit '68, qysh i keni përjetu ju qato?

Minir Dushi: Ato demonstratat e vitit '68, demonstratat e para kanë qenë, po unë me ju thanë të vërtetën nuk kom pasë dishka, se jam marrë me zhvillim e arsimit, kom qenë profesor në Shkollën e Lartë Teknike të Makinerisë si profesor inordinar aty me gradë shumë të lartë shkencore, njëheri edhe drejtor i Shkollës në Mitrovicë, në Mitrovicë asine. E kështu që, ato demonstrata kanë pasë një jehonë shumë të madhe edhe aty bili për herë të parë, a di, dihen ato si me thënë... shkëndijat e para për themelimin e Universitetit, Fakultetit të Prishtinës.

Eh mirë, kur u bënë pesë vjet punës sime në Shkollën e Lartë që u themelu e u konsolidu krejt, mua prapë më kthyen në Trepçe, se isha kuadër i Trepçës. Une kom doktorru shumë herët, tezën e doktoraturës e kom mbrojtë në Universitetin e Beogradit, jam i vetmi shqiptar që kom mbrojtë tezën e doktoraturës të Shkencave Teknike në Universitetin e Beogradit. Kjo ishte pesë vjet para se me u

themelu Universiteti i Prishtinës edhe ju thashë si e kryva misionin tim për Shkollën e Lartë, tani kthehem në Trepçe gjatë 1966-tën, atje me detyrë me themelu Fakultetin, me themelu Institutin e Trepçës për studimet, për hulumtimet shkencore në fushën e veprimtarisë Kombinatit të Trepçës të asaj kohe.

Domethanë, me 1 janar, 1966 është themelu Fakulteti, ky Instituti i Trepçës për Hulumtime në laminë e Plumb-Zinkut që e quanim atëherë Instituti i Plumb-Zinkut, e quanim ashtut pra. Aty kom qenë tetë vjet si drejtor i Institutit, por njëherit në vitin 1970 kur u themelu Universiteti i Prishtinës unë u zgjedha, u zgjedha prorektor i parë në Universitetin e Prishtinës në themelim, e që i patë këtu ato fotografite {bën me dorë nga tavolina}, aty kam qëndru...

Anita Susuri: E a mundesh me na tregu...

Minir Dushi: Njëherit edhe si prorektor, po edhe si drejtor në Institutin e Trepçës, e punëtor i Trepçës i pagum atje po ka se mungonin kuadrot me grada shkencore edhe e kisha vendin unë aty tash si prorektor.

Anita Susuri: Deshta me ju pyet, qysh kanë qenë kushtet e punës fillimisht kur keni shku në Trepçe edhe për juve po edhe për punëtorët që kanë qenë mbrenda që kanë punu në minierë faktikisht, edhe qysh ka ndryshu në kohën kur keni shku për së dyti?

Minir Dushi: Kushtet e punës gjithnjë tashti kanë ardhë duke u përmisu, u përmisunë nuk kanë qenë të këqija edhe tani nuk ka ma shtytjen e vagonave, por lokomotivat na erdhën lokomotivat, ngarkimi nuk u ba me dorë. Me dorë në kohën e britanikëve bllokat e xeheroret kaq {tregon me duar madhësinë}, që punë jashtëzankonisht e randë. Tani makinat ngarkuese janë përdorë për ngarkimin e xeherorit në vagona, vagona tërhiqen nga lokomotiva. E kështu që, puna ka ndryshuar njëqind për qind shumë e përmisunë dhe Trepça ka pasë prodhime të mdhaja. Ajo ashtë një temë tjetër, prodhimin e Trepçës e këto.

Anita Susuri: Po në vitin '58 kur keni fillu atëherë?

Minir Dushi: '58-shin.

Anita Susuri: Po, puna juj mbrenda minierës që thatë kam qenë, a ka qenë hulumtimi i terrenit a qysh ka qenë ma konkretisht?

Minir Dushi: Po atëherë ka qenë puna pak ma ndryshe është punuar, Trepça është një, një minierë botërore e njoftun ne botë, ka pasë shumë reparte.

Anita Susuri: Po, horizonte.

Minir Dushi: Po, horizonte. Pjesa e sipërme, nuk muj tash (qeshë) m'i paraftu ato, pjesa e sipërme e vendburimit, si i thojm na, u shfrytëzohke si i thojm na tash, tash ti ashtë një horizont që i thojnë 610-shi i mesmi ka zbrit deri në qatë prej 830-të në 610-të u shfrytëzu kta shkojnë në thellësi.

Anita Susuri: Sa horizonte kanë qenë atëherë ju kur keni shku fillimisht?

Minir Dushi: Une kur kom shku aty është punu en horizontin e pestë dhe të gjashtin, pestin edhe gjashtin.

Anita Susuri: Se tani janë nimdhetshi, i dymdheti ose i tremdheti është...

Minir Dushi: Tash është dymdhetshi.

Anita Susuri: Po.

Minir Dushi: Dymdhetshi, po muj me skema aty me ju tregu, po.

Anita Susuri: Po, e dijmë afërsisht, e dijmë qysh janë, po.

Minir Dushi: E, si thamë qashtu janë. Prodhimi aty ka shku normal. Trepça ka ardhë gjithnjë tu u rrit, tu u rrit, tu u zhvillu.

Anita Susuri: Ajo u bo si kombinat pastaj edhe me industrinë.

Minir Dushi: Pastaj, pastaj. E përpara kur kam ardhë unë në Trepçë, Trepça e kanë përbërë miniera Strantërgut, miniera e Trepçës në Strantërg, ka qenë flotacioni në Zveçan, ka qenë termocentrala e këto që prodhojnë energji elektrike, kjo ishte Trepça e asaj kohe. E pardon, edhe metalurgjia e objekti i metalurgjisë së plumbit e refinojë, këto kanë përba tre jo katër objekte e kanë përbërë Trepçën. I gjithë xeherori i plumb-zinkut janë Maqedonia, Serbia dhe është në Zveçan aty ku është përpunu, është përpunu në metal, do të thotë nxjerrjen e metalit asi si bahen. Çka pata tash une?

Anita Susuri: Pastaj më tregutë që herën e dytë kur erdhët, u rikthyet në Trepçë. Keni qëndru edhe tetë vite të tjera, po më duket?

Minir Dushi: Kur, në Trepçë herën e dytë?

Anita Susuri: Po, mbasi është themelu.

Minir Dushi: Aha, eh. Une pasi Universiteti u themelu, Instituti i Trepçës u themelu e, unë punonja një kohë si profesor në Universitetin e Prishtinës. Themelova Fakultetin e Xehetarisë e Metalurgjisë në Mitrovicë. Sa isha prorektor e kam injicu themelimin e këtij fakulteti, një fakultet jashtëzakonisht i fortë dhe i dobishëm, i dobishëm shumë. Më parë ishte selia e këtij fakulteti në Prishtinë si seksione të Fakultetit Teknik, ata ishin ndërtimtaria, makineria, elektroteknika, tash i bashkohet xehetaria, metalurgjia edhe teknologjia, këto një kohë pununë në Prishtinë dy vjet a tre.

Arritën manej mospajtime të mdhaja, këto ishin për, i takonin Fakultetit Teknik në Prishtinë por me selinë në Mitrovicë dhe nuk shkonin punët mirë, koordinimi e asi. Pasi nuk shkonin punët ashtu si duhet, organet kompetente të asaj kohe, të... Krahinës Autonome të Kosovës vendosën me themelu një fakultet të veçantë Fakultetin e Xehetarisë Metalurgjisë, ani pse ishte ky i formun atje ishte me Fakultetin Teknik degë e tij. Atë e lanë ashtu dhe e morëm këtë, të dyja i kam ba edhe ata edhe këta une i kam themelu, kjo ishte viti 1974.

‘74-trën kam qenë kryetar i Komisionit Amë për themelimin e Fakultetit, ashtë themelu Fakulteti me degët {tregon me gishtërinj}: xehetari, teknologji, metalurgji, ma vonë gjeologjia, mas tre vjete ka ardhur seksioni i gjeologjisë, seksione shumë të rëndësishme, shumë ndërlikume dhe u bë ajo komplet. ‘74-shin, kam qenë kur u themelu e komisioni amë, zgjedhi anëtarët për udhëheqjen e fakultetit, këtu i kam po {merr në dorë letrat}, unë isha zgjedhë si dekan, dekan i fakultetit aty kesh në parin mandat, mandej edhe në mandatin e dytë u zgjedha prapë.

E tash masi i kryva dy mandate unë kthehem në Kombinatin e Trepçës përsëri tash si, unë aty jam kanë kuadër i Trepçës, por që kam lëvizë andej këndeje sipas nevojës Trepçës, se Trepça ishte ajo që i stimulonte, i financonte, i... organizonte shkollimin e lartë për nevoja të veta në kuadra, s’kishin kuadro as synim, po na kem punu krejt për Trepçën, Fakulteti i Xehetarisë e Metalurgjisë ka punu 15 vjet. Nga ky fakultet janë dalë 1400 inxhinierë për këtë kohë prej tyne 300 e sa kanë qenë serbë, meqenëse universiteti i Prishtinës ka qenë dy-gjuhësor. 1100 kuadra e xehetarisë, gjeologjisë, metalurgjisë, teknologjisë, shqiptarë janë shpërnda nëpër miniera e fabrika të kombinatit e organizata punues. Ato kuadra e kanë mbajtë...

Anita Susuri: Ekonominë e Kosovës, Trepçën.

Minir Dushi: Absolutisht shumë bukur po thuni, po dhe mençuri e veçantë unë e quj dhe ashtu ashtë që udhëheqja e asaj kohe, që ka qenë kopentente për këto... këto formime e asi ka luajtu rol të jashtëzakonshëm në themelimin e Fakultetit të Xehetarisë dhe Metalurgjisë, sepse Trepça ka qenë e mbyllun për shqiptarë. Ajo ka qenë deri diku të gjitha kuadrot dhe udhëheqja kanë qenë serbe, edhe tash ti me daljen e kuadrove të reja nga Fakulteti i Xehetarisë Metalurgjisë u murrën të gjitha vendet kryesore në organizata punuese. E Trepça i ka pasë 27 organizata punuese, vetëm Trepça e vetëm aq nuk janë. Gjithkah kanë qenë kuadrot shqiptare që i kanë vendosur, prandaj po thom ajo ashtë një

strategji jashtëzakonisht e mençur e drejtë për me i futë kuadron tonë shqiptarë në udhëheqjen e Trepçës, meqenëse ajo ishte një organizatë e mbyllur vetëm për ta.

Anita Susuri: E vitet e '80-a, sidomos viti '81 që kanë qenë demonstratat atëhere janë shpalos edhe parullat si për shembull "Trepça punon, Beogradi ndërton", e këto. Qysh ka qenë krejt qajo përvoja e juaj në ato vitet e '80-a?

Minir Dushi: Une pasi e kryva mandatin tim dy herë në fakultet, tash u ktheva thashë në Trepçe.

Anita Susuri: Po.

Minir Dushi: E në Trepçe prapë me detyrë për rithemelimin e Institutit të Plumbit dhe të Zinkut të cilin e kishin...

Anita Susuri: Mbyll?

Minir Dushi: E kishin zhduk, e kishin deformat me do organizata palidhje krejt, sepse aty punët e Trepçës donte t'i bënte Instituti i tretë i xehetarisë, i tretë i Beogradit edhe nuk duronin ata fort Institutin e Plumb-Zink të Trepçës. E unë tani kam detyrë me e themelu, rithemeluar një Institut Shkencor edhe aty '78-shin, '79-shin, '80-shin deri në '81-shin është themelu një institut i veçantë shumë shkencor, në bazë të ligjit serb asokohe. Edhe Kosova sjelli ligjin për veprimtarinë shkencore dhe në bazë të atij ligji u themelu së dyti fakulteti, ky Instituti i Trepçës për Plumb e Zink në mënyrë... mënyrë ligjore sipas ligjit.

Atëherë mund t'ju thom intim, i lodhun, i lodhun deri qëtu {prek mjekrrën me gishtërinjë} me themelimin e Institutit të asaj kohe, kur plasin demonstratat në Universitetin e Prishtinës '81-shin edhe çka donë të thashë. Tani vijnë Fadil Hoxha, Deva, Veli Deva e këta, dhe m'fton në fakultetin e... në Universitetin e Prishtinës. Nuk e kisha në qejf fare atë punë në atë gjendje, në atë kaos që ishte bo që ishte dridhë krejt Jugosllavia me kenë në krye të Universitetit të Prishtinës.

Por, patjetër e sajoni si detyrë partiake pastaj kom marrë si... jom zgjedhë nga organet e Këshillit të Fakultetit, pleqësia në të vërtetë e fakultetit, më kanë zgjedhë si rektor edhe kom kalu ktu kom punu në ditët e kijametit, ajo është një temë e veçantë ashtë e përshkruajtun krejt ktu në këte libër {e shfleton librin}, çdo gjë. Asgjë s'kam lanë une pa e evidentuar edhe aty mbetet... edhe aty ke si ke vështirsina por demonstratat që e kanë dridhë krejt Jugosllavinë e që kanë qenë... kanë qenë ma universiteti që dul: *Tvrđava albanskih nacionalista* [srb.: Kështjella e nacionalistëve shqiptarë].

Anita Susuri: Kështjella e...

Minir Dushi: Ai gjenerali i armatës thonte për Universitetin, për bazë të demonstratave arritëm shumë askush nuk ashtë dënu thuja, askush nuk është përjashtu, janë ndërru vendet e punës disa njerëzve, kurgjo tjetër. Të gjitha janë këtu të shkruara.

Anita Susuri: Në rektorat apo kështu në përgjithësi po mendoni?

Minir Dushi: A?

Anita Susuri: Në rektorat nuk u ndryshu, po mendojë nuk u bo...

Minir Dushi: Jo, jo jo (qeshë), rektorati i fundit ashtë, Fakultetet, Shkollat e Larta që ishin sa ishin fakultete nantë a dhetë a, e Shkollat e Larta ja katëra pesë, ku ta di une.

Anita Susuri: Po du me thanë se atëherë ka fillu edhe...

Minir Dushi: Askush nuk jepte mësim.

Anita Susuri: Procesi i diferencimit...

Minir Dushi: A?

Anita Susuri: Procesi i diferencimit ka fillu ka qenë pak...

Minir Dushi: Jo, ishte një politikë e asaj kohe që me i ruajt kuadrot mos me përjashtue, mos me ndjek që t'kaloj kjo fortunë, a po kupton? Edhe u qetësu puna, u qetësu une pata aty ndejta dy vjet si mandatin e kryva me faqe të bardhë, me bashkëpunëtorët e mi jemi shumë krenarë që kemi qenë e që kemi kry atë detyrë aq të suksesshme edhe e kemi shpëtu krejt universitetin. Sot dikush flet kështu e flet ashtu, lexojnë qetu, le të lexojnë qetu {e prek librin mbi tavolinë}, le të kthehen në gjendjen e asaj kohe e atëhere mund të flasim na qetu.

Anita Susuri: A keni pasë ju, për shembull presion prej pushtetit ose ndonjë lloj... ?

Minir Dushi: Prej?

Anita Susuri: Prej vendit që, prej pushtetit po mendoj, prej qeverisjes.

Minir Dushi: Aspak jo, aspak jo. Mund të ju thom kështu tash s'po flas na e kemi pasë edhe Akademinë, kurrë një herë politika nuk ashtë përzi në punët e Akademisë te na, edhe këtu nuk ashtë përzi. U kanë komuniteti universitar, kryetari i komunitetit u ardhë në kuadër aty, nëpërmjet tyre i kem kry tana punët. E kështut pra, u kry qai mandat, shfletova, dola nga aty. Punova në fakultet, në fakultet kam

qenë, fakultetin tim punum po sërish domethanë. Pasi u kry edhe mandati i rektorit, por shpejtë u banë do zgjedhje, zgjedhje edhe mu më zgjodhën anëtar të Kryesisë të Kosovës edhe aty s’e kisha fare qejfin me shku, në atë kohë ‘89-she, ‘89-shen e ma përpara, pardon, ‘86-shën përtej ‘89-shit pastaj. Unë e di se si kam kalu, anëtar i kryesisë. “Po pse?” “Pse i ke punët mirë në universitet e je konë i suksesshëm e tash të qesim këtu në arsim”. Por s’e dojsa atë punë hiç, po u duhke dikush me kenë aty, pra. Edhe erdhi deri tek këputja suprimimi i autonomisë së Kosovës, që është një temë e veçantë.

Pjesa e Katërt

Anita Susuri: Paraprakisht po du me ju pytë për ‘88-ën, marshin kur e fillojnë minatorët, [17] nëntor të ‘88-tës.

Minir Dushi: A marshi, aha. Ato marrshet i kom përjetuar krejt duke qenë anëtar i kryesisë. Që vinin nga të gjitha trojet shqiptare, këtu të Kosovës, vinin në komë prej Gjakove, prej kahmosit. Me i marrë të ligat, si vinin këtu për me e mbrojtë autonominë e Kosovës. E gjithë popullata shqiptare.

Anita Susuri: A ju kujtohet minatorët kur kanë ardhë? Se po më duket se të parët kanë qenë që e kanë çelë...

Minir Dushi: E pastaj demonstratat, që ato ishin fillimi, demonstratat u përkrahën shumë nga populli, demonstratat u përkrahën nga minatorët, shumë u përkrahën. Edhe në bazë të përkrahjeve që u banë, u bënë grevat kur 1300 minatorë u mbyllën në thellësinë e horizonteve të Trepçës, tetë ditë aty. Unë kom qenë vazhdimisht aty se edhe punëtorë të mijë ata kanë qenë.

Anita Susuri: Greva e minatorëve?

Minir Dushi: Greva e minatorëve kur u... me horizontet e thella të minierës së Trepçës u blloku u mbyllën 1300 minatorë në shenjë të protestës mbrojtjes së autonomisë së Kosovës. Ajo që donin me e ndërru statusin e Kosovës, Millosheviqi me e hjek me asine, ata të parët kanë reagu në mënyrë dinjitoze ashtu që të gjithë janë mbyll në minierë, ku kanë mbetë pa ujë e pa bukë. Edhe të gjithë popullata e ka... e kanë përkrahë grevën e minatorëve dhe kanë bërë çmos, edhe studentët u mbyllën në palestrenë “1 Maji”, si po quhet aty?

Anita Susuri: “1 Tetori” tash.

Minir Dushi: Eh, “1 Tetori”, po. Eh, aty u mbyllën, u tubun një numër jashtëzakonisht i madh i...

Anita Susuri: Studentëve.

Minir Dushi: Studentëve dhe këmbëngulin përkrahjen dhe popullata përgjithshme. Edhe unë kom qenë asokohe si të thash anëtar i Kryesisë, po njëheri kom qenë punëtor i Trepçës ku kam punu po aty, kom pasu punëtorët e mij. Një pjesë të mirë të tyre, i kom vizitu shpesh kom shku poshtë, duke mos e ditë që unë e kam njeriun mbas të udhës, një punëtor timin në detyrë ka shkojë bashkë me mua ai. Eh, unë jam punëtor i joti profesor, e di këtë unë. Ai kish dalë në pension gjashtë muj përpara, kur del në pension e asi nuk kemi na pastaj llampën, ato llampat jipen në mënyrë të veçantë i kanë ato shenjat e, maticat⁵ ku ma jep numrin katërsh që është numri jem. E ky tash u dalë që nuk ka numër të vetin. Kush ta dha llampën? Drejtor ishte...

Anita Susuri: [Burhan Kavaja?](#)

Minir Dushi: Kraja, ky...

Anita Susuri: Kavaja?

Minir Dushi: Kavaja, Burhan Kavaja, po. Burhan Kavaja ishim bashkë, ai ka qenë student i imi po en' lift po hecim, ai njeri me ne. Edhe Burhani e njofti menjëherë, i tha, "Ha edhe ti këtu, kush ta dha llampën ty?" UDB-ja ja ka dhonë, "Po unë e këtu asine..." "Po ti që gjashtë muj je dalë n'pension". E dike ky si drejtor, po ai ishte me detyrë me asina, kështu që...

Anita Susuri: A e kthyen pastaj atë? A e lanë me hy atë personin?

Minir Dushi: Ja, ai shkoj po. Unë nuk isha tana heret aty që është e vërteta, por shkonja shpesh edhe rrinja edhe natën rrinja.

Anita Susuri: E qysh ka qenë krejt qajo gjendja e minatorëve? A mundeni me përshkru çka keni pa?

Minir Dushi: Po bre, çka me përshkru? Përgjithësisht ka qenë një ambullantë e improvizime me kreveta, me këto krejt. Kur sëmuheshin herë najhere dilte jashtë e në ambullantë aty e qunin spitali, spitali minatorëve asi here. Po kishte raste të ndryshme, kishin vdekje në familje minatorët nuk dilnin, nuk donin me shku. Me lanë aty, nuk donin. Ma së mrami me tradhti, me tradhti u nxorrën minatorët prej minierës, por e vazhdun atë siç dihet masnej. Masnej burgime, janë burgos {lexon në letër}...

Anita Susuri: 14-të vetë.

Minir Dushi: Me numra po du me fol se i di, por edhe 60 e sa vetë kanë vuajt, janë dënu prej minatorit 30 deri në 60 ditë burg, a po kupton? E pastaj tjerë e tjerë e, shumë kanë qenë, ajo ka qenë një gjo madhore. Kur e tërë Jugosllavia e veçantë Sllovenia dha përkrahje të madhe prej gjitha atyre ngjarjeve tona këtu, se ishte një shtet i emancipum ma tepër, demokratik afër Evropës me Evropën.

⁵ Pajisje mekanike që përdoret për fiksion ose rregullim.

Anita Susuri: Ju thatë që keni qenë aty edhe Stipe Šuvar kur ka ardhur?

Minir Dushi: E, erdhi Stipe Šuvari don me bisedu me minatorët. Minatorët, “Hajde shkojmë”, thashë, “Bre, ashtë t’u ardhë Stipe Šuvari”. “Nuk e dojna, nuk dojm me bisedu, nuk dojm!” Dhe refuzohet biseda. Pastaj fillojnë këto burgimet, 14 janë burgosë këta...

Anita Susuri: Aziz Abrashi, Burhani e këta.

Minir Dushi: [Azem Vllasi](#) e këta krejt asine, ata nëpër gjykime të mëdhaja e asine. Përveç atyne që ishin ka 30-60 ditë burg e asi, një, një si me thanë aferë jo por, që i thonë një fortunë i thonë qashtut..

Anita Susuri: E qysh e pritët ju qatë lajm për burgosjen e ktyne, që kanë qenë faktikisht edhe nxansat e juve.

Minir Dushi: Po unë kom punu bashkë edhe me Azemin, kemi pasë po get partia kemi qenë ende të angazhum për Mitrovicën. Unë ma atjene gjithësesi, tashti edhe Azemi, por edhe tash ka kalu bukur një kohë e gjatë e gjërat janë harruar por kur asi (qeshë), por mes disave ma kryesore a din. Por kanë qenë gjona se bashkë kemi shku nëpër mbledhje, e minatorët asina, çka folnin e folnin e kështu tana.

Anita Susuri: E ju thatë që deri në ‘89-ën keni qenë...

Minir Dushi: Ku?

Anita Susuri: Keni qenë prej... deri në ‘89-ën keni qenë në... i angazhum si rektor apo?

Minir Dushi: Si?

Anita Susuri: Si rektor.

Minir Dushi: Si rektor?

Anita Susuri: Deri në ‘89-ën apo?

Minir Dushi: Po, ja ja, ja. Si rektor kom qenë ‘81-shin, ‘82-shin, ‘83-shin deri në ‘84-shin.

Anita Susuri: Po, pastaj në Trepçe e keni pranuar po m’duket apo?

Minir Dushi: Pastaj, erdha edhe afër pensionit e krejt asine, çfarë bona duhet me u kujtu valla me ju thanë të vërtetën (qesh). Kështu qi jeta e ime në përgjithësi ka qenë shumë, shumë e bujshme, e vuajtshme. Une meqenëse jam marrë gjithnjë me themelimin e institucioneve...

Anita Susuri: Të arsimit, industrisë.

Minir Dushi: Të arsimit, shkencës. Pa konkurs në detyrë, gjithnjë kam shkuar a Shkolla e Lartë, a Fakulteti i Xehetarisë e Metalurgjisë, a Instituti i Trepçës, a Universiteti i Prishtinës, si punëtor shkencor pak kom mujt me u marrë me botime me këtë. Po materiale kam mbledhë shumë, kështu që prej vitit kur kam fillu qeto të Trepçës '62-shin e 2002-shin, kom zhvillu veprimtari të madhe shkencore, kom botuar 18 libra.

Anita Susuri: Prej 2002-ës keni fillu me botu libra?

Minir Dushi: Jo, ka pasë edhe ma përpara, kanë qenë disa tekste universitare, janë konë katër a pesë a gjashtë, qashtu diçka. E këto tjerat krejt i kam punu prej 2002-shit e knena. Edhe është përfshi i gjithë xehetaria dhe gjeologjia e Kosovës, krejt kush ka e ka atëherë janë ba hulumtime të jashtëzakonshme en' Kosovë. Janë dhanë paret e mdhaja edhe nga federata edhe nga Trepça. Trepça i ka pasë kete ekipin, jo ekipin por Shërbimin Gjeologjik, Shërbimi Gjeologjik i Trepçës ka qenë më i miri jo në Jugosllavi po kudo. Shumë kanë punu ata gjethka, janë aty disa komente i kam pasë nën kujdesje edhe në Trepçë sa jom kanë krejt, se të gjitha kanë shku nëpërmjet meje, durve të mia dhe këto janë pasqyru në këto librat e mia krejt ato.

Qato, qai Shërbimi Gjeologjik i Trepçës prej tyne janë themeleu të gjitha institucionet e xehetarisë e metalurgjisë në Beograd. Kjo *zavodet* [srb.: Enti] për jo metale, kjo *zavodet*, kjo zavodi i hulumtimeve nukleare, Instituti i Xehetarisë Zemun, e të gjithë prej kuadrove të Trepçës, andrra e Trepçës. Trepça ka pasë qashtu za, e afirmume në botë, jo krejt në botë po gati bukur, bukur mirë de. Vinin tek na inxhiniera nga Serbia e me ardhë me punu tre mujë ditë këtu, katër mujë pa pagesë hiç, "Viç me ma dhanë vulën që kom punu në Trepçë (qesh). E në botë me u paraqitë edhe se jam punëtor i Trepçës, inxhinier i Trepçës". Dyrte e çelne gjithkrah, qështu ka qenë.

Anita Susuri: Industri e fortë ka qenë, po deshta...

Minir Dushi: Ajo është një dishka, dishka e veçantë. Po une shpirtnisht jam lëshu në to i di ato sene krejt si, si, si e kam përkushtu krejt jetën sime te ato. E, i ndijë, i ndijë shumë asine, përveç aty që i kom përshkru në asi i kom vetëm thash 18 libra i kom, por edhe i kom edhe 250 në punime, në punime në... këtë si i thojnë e... revista të ndryshme po du me thanë.

Anita Susuri: Revista shkencore.

Minir Dushi: Po na i qujmë ndryshe se... (qesh).

Anita Susuri: Aha, ani.

Minir Dushi: Po. Nejse çka s'po më asih po, janë të veçanta ato domethanë. Qetu janë do libra të mijat {tregon librat me dorë}, ju luta ktyne këtu çoni në magazinë mos ka naj libër mos të jesin ktu, që ka metë qe kjo shkoj ktu. Edhe ato zojat m'i prunë pak përpara i kanë gjetë do libra, m'i prunë me ja dhanë qetu te Komisoni për Miniera e Minerale, qe.

Anita Susuri: Zotri Minir, deshta me ju të vetë se nashti ju e dini ose keni lexu nëpër arkiva diçka, për periudhën e Luftës së yhtë Botërore në Trepçe, thonë që ka pasë edhe robë të luftës që kanë punu ose që kanë qenë si një lloj kampi?

Minir Dushi: Çka ka qenë?

Anita Susuri: Si një lloj kampi për robët e luftës, ndoshta dini juve diçka keni ndëgju.

Minir Dushi: A, nuk di gja për ato, si rob lufte kanë qenë mas çlirimit, gjermanët kan qenë aty një pjesë e gjermanëve që janë zanë robë, po edhe ata kanë punu bukur një kohë, ku ta di une nuk e di se sa, se si kom mrri ato. Ka qenë herët, une hala s'jom kanë knene, po, po në kohën e Gjermanisë, Gjermania e ka pasë (qesh). Hitleri ka pasë biseda të veçanta me britanikët që kur ta marrin Jugosllavinë, Trepçën me na dorëzu komplet qysh ashtë mos me pytë pse asine. Hiç pa pritë atëhere na masakrun Gjermanët edhe e kanë pshtu punën. Politika tjera atëherë (qesh).

Anita Susuri: E në cilin vit keni dalë në pension ju, vitet '90-a a kur keni dalë?

Minir Dushi: Si?

Anita Susuri: Në pension kur keni dalë?

Minir Dushi: '92-shin, kom dalë në pension sa kam qenë në fakultet tu punu, në fakultetin tim të Mitrovicës. Atje, e pastaj me Akademi jam marrë.

Anita Susuri: Ka qenë...

Minir Dushi: Une jam një. Muj me thanë jam edhe një njëri nga themeluesit e Akademisë Shkencave të Arteve të Kosovë, jo jo, Akademinë e ka formu shteti po dikush u duhtë me i bajt senet prapë. 50, a doni t'ju flas diçka për ta?

Anita Susuri: Po, bon.

Minir Dushi: Po, domethanë, disa fjalë. Si u themelua Akademia? Në vitin 1970, jo, jo, nalu tash ktu. 1900... mirë thash 1974-shin, Kuvendi i Kosovës ka sjellë ligjin për themelimin e Akademisë Shkencave. Në të vërtetë për zgjedhjen e komisionit amë për themelimin e, themelimin e Akademisë së Shkencave Arteve së Kosovës. Anëtar të... të komisionit amë kanë qenë kryetari akademike tjera të Republikave të Jugosllavisë, Jugosllavia i kanë pas gjashtë. Ata kryetarët kanë qenë anëtar të komisionit themelues të akademisë sonë, kryetari i tyre ka qenë kryetari i Akademisë Shkencave të Serbisë, kryetar ka qenë... ka qenë ky shkenctari i njoftun Sreten. Pra, që ka punu në Francë e asi nuk desht me ardhë edhe ai asi e çojnë nënkryetarin, nënkryetari u bo kryetar i komisionit amë.

Komisioni amë përzgjedhjen e anëtarëve atëhere ma përpara gjithçka nuk ashtë shku meniherë në mbledhje te Akademia shumë sene, Universiteti, në Shkollët e Larta anej kadale, mandej Fakulteti. Edhe këtu në Akademi ma s'pari ashtë përzgjedhë Shoqatën e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, atë e kanë pasë edhe në Mal të Zi edhe Vojvodina partej. Ma s'pari i kanë formu Shoqatën e Shkencave dhe të Arteve pastaj atë e kanë shndërru në Akademi. E na e themelum Shoqatën e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Kanaziri si kryetar i i komisionit amë pastaj këta zgjedhën anëtarë të Akademisë, i kanë zgjedhë nimdhetë anëtarë të rregullt e dy korrespondentë. Gjenerata e parë e akademikëve ka pasë trembëdhjetë akademikë, njëni prej tyre jam une hala gjallë, njëni prej tyre edhe Rexhep Qosja, edhe ai është. Na dy jemi gjallë hala prej qatëherit.

Anita Susuri: Prej gjeneratës të parë!

Minir Dushi: Gjeneratës parë kta. E tash, ka pas shumë rezistenca, kundërshtime për themelimin e Akademisë dhe të... ai komisioni jo, po për gjuhën, letërsinë e kulturës, qysh ke ajo asi po, e Kosovës, që mahen vjet për vjet albanologë.

Anita Susuri: Kongresi a?

Minir Dushi: A?

Anita Susuri: Kongresi?

Minir Dushi: Ja ja, nuk o kongres ajo po...

Anita Susuri: Komisioni? Diçka s'po di.

Minir Dushi: Po thom tash ti e ka emrin e vetë ajo dhe për çdo vjet mahen asine. Kto dy, domethanë akademia edhe gjuha edhe kultura shqiptare kundërshtime të jashtëzakonshme, stërmenisat [ekzagjërime], pse këto janë elemente të shtetit, akademinë kanë shtetet jo autonomia. Këto, pra kulturën seminari, seminari i kulturës (qesh).

Anita Susuri: Aha, seminari.

Minir Dushi: Po, i gjuhës dhe i letërsisë shqipe a po kuptoni? Edhe ajo ashtë vetëm i republikave, ka pasë kundërshtime por u mujtën ata, u mujtën edhe unë në atë kohë për veti unë kom qenë kryetar i... i Enteve Shkencore të Kosovës, kryetarë i Enteve të... Enteve Shkencore të Kosovës, kjo formë e një Akademie si me thanë, edhe jam marrë me shumë me themelimin e Akademisë kto deshta të thom. Si kryetar i Bashkësisë dhe Enteve Shkencore të Kosovës, e kështu ktu ka shumë dhana për të fol, mirëpo u mposhtën dhe u formu edhe njëra edhe tjetra, u formunë edhe gjallojnë edhe sot. Natyrisht që Akademia edhe seminari (qesh) që s'mu kujtoka emri seminarit.

Anita Susuri: E në kohën kur keni...

Minir Dushi: Nashta e kryjm qetashti apo jo?

Anita Susuri: Ani, qysh dush!

Minir Dushi: Jo, jo, po pata diçka të veçantë urdhno.

Anita Susuri: Jo, veç nëse doni me fol për pensionin, po më duket e keni kalu tu publiku...

Minir Dushi: Kan?

Anita Susuri: Pensionimin, kur keni dalë në pension, keni publiku libra sigurisht qatë kohë që folët më herët.

Minir Dushi: A, shka kom ba une atëhjere, tash më keni shti me mendu (qesh).

Anita Susuri: Qysh të doni me tregu pak për pensionin.

Minir Dushi: Jo, për pensionin...

Anita Susuri: Se kogja ni pension i gatë (qesh).

Minir Dushi: I gjatë!

Anita Susuri: Po.

Minir Dushi: '92-shin derë më sot, po po kujtona po thom çka shka bana une atëhere ku isha te kisha se shumë ndrrun, po... jam marrë kryesisht me Akademi atëhere. Me Akademi po... une asnjherë nuk

kam qenë kryetar i Akademisë, nuk kom qenë s'kom dashtë, sa here kisha dashtë isha ba vetë. Por jom marrë me këto punë të mëdhaja knene, kolegët e mi kanë qenë ma të lirë ata le të jenë kryetarë. Pas demonstratave, u bo presion i madh u murr veshë nga ana e serbëve e përgjithësi e veçantë atyne shovenistave e nacionalistave, unë tash ti nuk ka m'u konë rektori tana here shqiptarë, nuk ka m'u kanë tana here kryetari i Akademisë serb, jo, jo shqiptar, a ktu kanë qenë të pëcaktume ma përpara vetëm shqiptarë, edhe presioni i madh u deshtë me lshu pej, u deshtë me lshu pej.

Atëhere kanë planifiku le të jem kryetar i Akademisë në pension që isha, para se mu zgjedhë në Akademi, neee... kryesinë, hyn në kryesi '86-shën, 1986-shën, thonë për kryetar une mrena, po Azemi, "Minir kemi me ndrru strukturën patjetër, aty p'e lajna Fukë Filipoviqin", që e keni pa ktu {drejtohet tek libri}, "kryetar ti metë nënkryetar por njëherit edhe anëtar i kryesisë". Siç është po ju flas për nder. "Mirë tash, mirë". Atëhere u folke kapak pse ka dy funksione, a din, edhe une s'kish nevojë për dy funksione. Mas nja dy jave aty po i thom qe u banë zgjedhjet, unë bahna nënkryetar, Filipoviqi u bë kryetar, une edhe një herë anëtar i kryesisë.

"Azem, kom vendos me lon Akademinë..." "Minir, ti qysh dush. Në komunitet ne kemi vendos me kenë atje edhe atje, qeshtu kem vendos, ti si të dush". "Po e meno". "Meno", tha. Kom menu edhe ja, mas dy jave prapë me Azemin. "Azem", thashë, "du me lonë Akademinë". Atëhere u zgjidh Vuk Filipoviqi, e qe une meta, jo jo, pardon pardon. Ja se gabova (qesh). Ata veç kem zgjedh na, ai kryetar, une nënkryetar, "Po e lo" thashë, "Akademinë po mbetem në kryesi". Edhe e lashë Akademinë aty e zgjedhën Muslimin... Muslim artisitin këto Eba Muslimi na i thojm, Muslim...

Anita Susuri: Mulliqin, Muslim Mulliqi?

Minir Dushi: Mulliqin po, neyse ai më zavendsoi aty. E prandaj nuk jam asine, nuk kam qenë në Akademi në udhëheqje. E një herë tjetër, jo edhe nja dy, tre here jam zgjedh nënkryetar po s'kom dashtë. Une ose me u ba kryetar për biografi, për biografi, sinqerisht po ju thom. Po, nuk um pranunë kryetar, e kom lanë. '92-shin u zgjodhën, i patën zgjedhjet në Akademi, u zgjodha, ishte qëndrimi jonë me u ba kryetar edhe, "Jo", thanëm "se tashti është demokracia dojmë me qitë ma tepër kandidatë". Edhe i qitën Mark Krasniqin, e qitën Musa, mjeku ky, Musa Haxhinë, Musa Haxhia mjek, edhe u banë votimet.

Musa Haxhia tetë vota, Minir Dushi, Mark Krasniqi një votë, një votë. Ra Marki, tash edhe një here na dy cili po asine, prapë për një votë ai ke ma tepër Musa Haxhia, une thash po ia lshoj venin Markit. Ashtë e shkrujtun ktu, e shkrujtun po. E, une po tërheqna krejt, u tërhjeka krejt, u ba Marki nënkryetar. Erdh rrufeja ajo atje u banë shpërndarje, na shpërngulën prej Akademisë asi, edhe ai Musa Haxhia shkoi në Amerikë, në Amerikë shka u ba tash, vetë kryetarë (qesh). Qashtu ka qenë origjinal, shkrun aty asina. E qeshtu disa që këto janë pak asi, noshta jashtë kësaj bisede.

Anita Susuri: Jo, pjesë e krejtë...

Minir Dushi: Jashta kësaj bisede.

Anita Susuri: Po qysh kanë qenë qato vitet e '90-a, kur kanë qenë institucionet paralele, qysh ka ndiku krejt te ju kjo?

Minir Dushi: Ku?

Anita Susuri: Institucionet paralele kur u bënë '90-at që ma nuk patët vend nëpër institucione, qysh ka shku kjo te ju?

Minir Dushi: Nuk kam ngjarje me to, institucionet paralele u bënë në arsim e disa asine, por une nuk jam konë as në Lidhjen Demokratike, manej edhe u tërhoqa edhe prej partisë moniste, se u tërheqëm krejt masnej. Masnej nuk kam qenë shumë në asina. Ku e di tash, ngjarjet ndryshojnë shumë, por s'kam nevojë me asi, se janë ndryshe.

Anita Susuri: Ani, zotëri Minir, nëse doni edhe diçka me kallxu, me shtu?

Minir Dushi: Vallahi, falemineres po ju thom se...